REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 2198 VENDIMIT

2198

# V E N D I M
## PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Sot, me date 1.3.1994, une gjyqtarja e gjykates se rrethit Tirane, Florina Tegu, mora ne shqyrtim materialet e paraqitura nga kerkuesit :GIOVANI SACCO i biri i Nikolas dhe i Bughi Adele, lindur me 1945 ne Lecce dhe banues ne Lecce Via Cavallieri Ordine Vittorio Venetto 43 me kombesi Italiane

ADIL BEQIRAJ, i biri i Vehbiut dhe Zyrase, lindu r me 18.8.1958 ne Durres dhe banues ne Durres L.16 rr."Mujo Ulqinaku" Nr.140, me kombesi shqipetare.

## K O N S T A T O V A

Kerkesa e kerkuesve Giovani Sacco e Adil Beqiraj per te ushtruar aktivitetin privat ne formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizur(SHPK) me emertimin " GIO AD" ne fushen e veprimtarise:

Tregetimin me pakic e shumice te pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e tipet e automjeteve import eksport.

Tregetimin me shumice e pakic te paisjeve te ndryshme industriale, elektroshtepijake, konfeksione, prodhime kozmetike, ondulacion, lende ndertimi, makineri e paisje; prodhime plastike e gome, lodra per femije import eksport.

Te kryej te gjitha operacionet tregetare, ekonomike e financiare qe jane te lidhura me objektin e veprimtarise se saje dhe qe shihet e nevojeshme ose e domosdoshme nga administratori i Shoqerise.

Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 leke .

Selia e Shoqerise eshte ne Durres ,Lagja 16 , rruga "Mujo Ulqinaku ", Nr.140 .

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete mbi 10 vjet .

Administrator i Shoqerise do te jete ADIL BEQIRAJ .

## PER KETO ARESYE

Ne baze te nenit 5 te Ligjit Nr.7512 date 10.8.1991

te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992 dhe te Ligjit Nr. 7667 date 28.1.19
" Per regjistrin Tregetar "

V E N D O S A

Regjistrimin e Shoqerise " GEOAD " SHPK si person j
ridik per te ushtruar veprimtarine private ne fushen :

- Tregetimin me pakice e shumice te pjeseve te kemb
mit per te gjithe llojet e tipet e autompjeteve import eksport .

- Tregetimin me shumice e pakice te pajisjeve te nd
shme industriale, elektroshtepiake, konfeksione, prodhime kozmetike,
dulacione , lende ndertimi , makineri e pajisje, prodhime plastike e
me, lodra per femije , import eksport .

- Te kryeje te gjitha operacionet tregetare , ekonom
ke e financiare qe jane te lidhura me objektin e veprimtarise se Shoq
-se dhe qe shihet e nevojeshme ose e domosdoshme nga administratori i
Shoqerise .

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke
Selia e Shoqerise eshte ne Durres , Lagja 16, rrug
"Mujo Ulqinaku ", Nr.140 .

Kohezgjatja e Shoqerise do te jete mbi 10 vjet .
Administrator i Shoqerise do te jete ADIL BEQIRAJ

Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne shkall
te dyte .

G J Y Q T A R E :

REPUBLIKA E SHQIPERISE

GJYKATA E RRETHIT TIRANE

Nr. 219/1 Vendimi

# V E N D I M

## " I GJYQTARIT TE VETEM "

Sot me date 16-02-2000 une gjyqtarje e Gjykates se Rrethit Tirane M. Jeoli mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Adil Beqiraj per depozitimin e dokumentave per ndryshime ne Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar " "GIOAD" SHPK DURRES

## V E R E J

Shoqeria "GIOAD" SHPK eshte miratuar si Person juridik me vendim te Gjykates se Rrethit Tirane Nr.2198 date 01.03.1994 me ortek Adil Beqiraj e Gioveni Sacco.

Me vendim te ortakeve te Shoqerise date 24.01.2000 eshte vendosur te behen ndryshimet si me poshte :

Te shtoje aktivitetin ne fushen e parukerise si dhe servis automjeti.

Te reflektohen ndryshimet ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

Nga dokumentat e paraqitura rezulton se kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

## P E R   K E T O   A R S Y E

Ne baze te ligjit 7667 date 20 janar 1993

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Te depozitoje kerkesen dhe dokumentat e paraqitura nga kerkuesi Adil Beqiraj administrator i Sh.P.K."GIOAD" DURRES per te reflektuar ndryshimet ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane kollona 4. pike ______.

G J Y Q T A R

Mariana Jeoli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
Nr. 2198/2

# V E N D I M
## I GJYQTARIT TE VETEM

Sot me date 17.10. 2000 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane Majlinda Dogga,mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkues Adil Beqiraj administrator i shoqerise GIOAD Durres shpk dhe

## K O N S T A T O V A

Se shoqeria " GIOAD " shpk eshte regjistruar si person juridik ne Gjykaten e rrethit Tirane me vendimin nr 2198 dt.01.03.1994,me ortak z.Adil Beqiraj dhe GIOVANI Sacco.

Me vendimin nr.2198/1 dt.24.01.2000 eshte vendosur shtimi i objekt te shoqerise ne fushen e parukerise si dhe servis automjeti.

Me vendimin nr.2 te asamlese se ortakeve te shoqerise "GIOAD " shp date.15.10.2000 eshte vendosur shtimi i objektit te veprimtarise se shoqerise edhe me kurse te formimitprofesional ne fushen e parukerise.

Pas ketij vendimi objekti i veprimtarise se shoqerise behet si me poshte :

Tregtim me pakice dhe shumice te gjithe pjeseve te kembimit te tipe dhe gjithe llojeve te automjeteve import eksport.Tregtimin me shumice dhe pakice te paisjeve te ndryshme industriale,elektroshtepiake,konfeks one,prodhime kozmetike,ondulacioni,lende ndertimi,makineri e paisje, prodhime plastike dhe goma,lodra per femije,import eksport.

Ne fushen e parukerise ,si dhe servis automjetesh,kurse te formimit profesional ne fushen e parukerise.

Kerkesa eshte e drejte dhe e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit 7667 date 28.01.1993 dhe ligjit 7638 date 19.1192

## V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise GIOAD shpk per shtimin e objektit te veprimtarise.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje shenimet perkatese.

G J Y Q T A R E
MAJLINDA DOGGA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT TIRANE
NR 2198 VENDIMIT
/3

**VENDIM**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane, sot me date 02-04- 2004, une gjyqtarja e gjykates se rrethit Tirane, mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga z. Adil Beqiraj dhe Giovanni Sacco

KONSTATOVA

Se shoqeria GIOAD SHPK eshte e regjistruar si person juridik privat me Vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 2198 date 01.03.1994 mbas te cilit me Vendimet nr. 2198/1 date 24.02.2000 dhe nr. 2198/2 date 17.10.2000 te kesaj Gjykate jane bere shtesat perkatese dhe aktualisht vepron me Ortak dhe Administrator zotin Adil BEQIRAJ dhe me ortak zotin Giovanni SACCO, me seli ne qytetin e Durresit, Lagja nr.16, Rr Mujo Ulqinaku, me kapital themelor 100.000 leke, me kohezgjatje mbi 10 vjet, duke patur si objekt veprimtarie: '' **tregetim me shumice e pakice te pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e tipat e automjeteve import-export, tregetim me shumice e pakice te pajisjeve te ndryshme industriale, elektroshtepiake, konfeksione, prodhime kozmetike, ondulazioni, lende adertimi, makineri e pajisje, prodhime plastike e gome, lodra per femije import-export, te kryeje te gjitha operacionet tregtare, ekonomike e finanziare qe jane te lidhura me obejktin e veprimtarise se saj dhe qe shihet e nevojshme ose e domosdoshme nga administratori i shoqerise , parukeri, servis automjetesh, kurse te formimit profesional ne fushen e parukerise** ''

Sipas kerkeses se Ortakut Giovanni SACCO eshte miratuar largimi i tij nga shoqeria GIOAD SHPK, sipas deklarates noteriale vertetuar ne dhomen e noterete Durres nr. 1141/141 date 29.03.2004. Ndersa me kontraten e shitjes se kuotes nr. 1141/141 date 29.03.2004 vertetuar nga Dhoma e Noterve Durres (N. Bujar Troci) pjesa takuese e kapitalit te zotit Giovanni SACCO ka kaluar ne pronesine e z. Adil BEQIRAJ i cili mbetet pronar i vetem i gjithe kapitali

Lidhur me veprimet e siperme, nga ortaket(Asamblea) jane miratuar amendamentet shtese te shoqerise per ndryshimin ne paragrafin e pare te Aktit te Themelimit dhe te Statutit si dhe ndryshimin ne nenin 19 te Statutit, duke mbetur Ortak i Vetem dhe Administrator i Shoqerise zoti Adil Beqiraj me pjese 100% te kapitalit, pa ndryshuar emri, selia, objekti i veprimtarise dhe kohezgjatja e shoqerise.

Kerkesa eshte e bazuar ne ligj dhe si e tille ajo duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te Ligjit nr. 7512 date 10.03.1991, Ligjit nr. 7638 date 19.11.1992 dhe Ligjit nr. 7667 date 28.01.1993

VENDOSA

**Pranimin e kerkeses**

**Depozitimin e vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise GIOAD SHPK Durres per largimin nga shoqeria tregtare GIOAD SHPK e ortakut Giovanni SACCO.**

Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje shenimet perkatese

GJYQTARE

Mariana Deoli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
Nr.______/4 Vendimit

# V E N D I M

## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 15.6.2004 une Gjyqtare e Gjykates se shkalles se pare Tirane ______ mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi:
- **Adil Beqiraj,** per depozitimin prane regjistrit tregetar te vendimit te ortakut te vetem te shoqerise tregetare " **GIOAD** " sh.p.k. dhe:

KONSTATOVA

Se me vendimin **Nr.** 2188 dt. 1.3.1994 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregetare " **GIOAD** " sh.p.k.

Me vendimin Nr. 2188 /1, eshte bere ndryshim ne kete shoqeri.

Me vendimin **Nr. 2** dt. 09.06.2004 te ortakut te vetem te shoqerise tregetare " **GIOAD** " sh.p.k. eshte vendosur te shtohet objekti i veprimtarise ne fushen e:

- Zhvillimin e kurseve te trajnimit jo vetem ne fushen e parrukerise, por te veproje si nje qender multi profesionale edhe ne fushen e elektricitetit, mekanikes, hidraulikes, paneleve diellore, hotelerise, banakierit, picaiolit, kuzhinierit, pastiçierit, kompiuterit, dhe te çdo lloj profesioni qe lidhet me trajnimin profesional.
- Te zhvilloje aktivitet ne fushen e restoranteve, hoteleve dhe te çdo lloj tjeter aktiviteti menaxhues, si perdorues apo tregetar.

PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit **Nr.7638**, date 19.11.1992, te Ligjit **Nr.7667** date 28.01.1993:

# V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrit tregetar te Gjykates te vendimit **Nr. 2** dt. 09.06.2004 te ortakut te vetem te shoqerise tregetare " **GIOAD** " sh.p.k. ku eshte vendosur te shtohet objekti i veprimtarise ne fushen e:

- Zhvillimin e kurseve te trajnimit jo vetem ne fushen e parrukerise, por te veproje si nje qender multi profesionale edhe ne fushen e elektricitetit, mekanikes, hidraulikes, paneleve diellore, hotelerise, banakierit, picaiolit, kuzhinierit, pastiçierit, kompiuterit, dhe te çdo lloj profesioni qe lidhet me trajnimin profesional.
- Te zhvilloje aktivitet ne fushen e restoranteve, hoteleve dhe te çdo lloj tjeter aktiviteti menaxhues, si perdorues apo tregetar.

Urdherohet zyra e regjistrit tregetar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr 2198/5 VENDIMI

# V E N D I M

Ne Tirane ,sot ne date 05.12.06 une [signature] Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjygjsor Tirane,pasi u njoha me kerkesen e kerkuesit Adil Beqiraj:

## K O N S T A T O V A S E

Shoqeria Tregtare '' Gioad '' shpk, eshte regjistruar prane Zyres se Regjistrit Tregtar me Vendimin Nr.2198 date 01.03.1194; Nr.2198/1 date 24.02.2000 ; Nr.2198/2 date 17.10.2000; Nr.2198/3 date 02.04.2004 dhe Nr.2198/4 date 15.06.2004.

Me vendimin Nr.5 date 20.06.2006,Ortaku I vetem I Shoqerise Tregtare ''Gioad'' shpk ka vendosur:

-Miratimin e llogarive vjetore te Shoqerise Tregtare ''Gioad'' shpk per vitin financiar 2005 (01 Janar – 31 Dhjetor 2005 ).

- Zmadhimi I kapitalit themeltar te neneshkruar te shoqerise tregtare''Gioad ''shpk,gje e cila do te arrihet me fitimet e rezervat e pashperndara,gjendje me date 31.12.2005.
- Te caktoje znj. Nadire Hyseni,anetare e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar,me profesjon Eksperte Kontabel e Autorizuar me Nr.License 43 date 10.02.2000 ,dhe kod fiscal 540855 per vleresimin e zmadhimit te kapitalit themeltar me fitimet e pashperndara te shoqerise dhe llogarine Ortake llogari rrjedhese gjedje te dates 31.12.2005.
- Depozitimin e ketij vendimi prane Zyres se Regjistrit Tregetar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor TIRANE.

Me anen te kerkeses se tij,administratori dhe Ortaku I vetem I shoqerise,kerkon qe te depozitohet ky vendim prane Zyres se Rregjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane,duke bere shenimet perkatese.

Kerkesa e tij eshte e drejte,e bazuar ne ligj dhe si e tille duhet pranuar.

PER KETO ARESYE

Bazuar ne Ligjin Nr. 7667 date 28.01.1993 ''Per regjistrin Tregtar dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare''.

VENDOSA

- Pranimin e kerkeses.
- Depozitimin e Vendimit Nr.5 date 20.06.2006 te Ortakut te Vetem te shoqerise tregtare '' Gioad'' shpk prane Zyres se regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjygjesor Tirane.
- Caktimin e znj. NADIRE HYSENI, Eksperte kontabel e Autorizuar,anetare e Institutit te Eksperteve kontabel te autorizuar, me Nr, License 43 date 10.02.2000 qe te beje vleresimin e kapitalit themeltar ne baze te fitimeve te pashperndara dhe llogarise Ortake llogari likujduese,gjendje sipas bilancit te mbyllur me 31.12.2005
- Urdherohet Zyra e Regjistrit Tregtar te beje shenimet perkatese

Kunder ketij vendimi lejohet ankim.

GJYQTARE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYGJESOR TIRANE**
**Nr.______/Vendimi**

2198/6

**V E N D I M**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Sot me date 15/3/2007, une Gjyqtare prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane ____________, pasi shqyrtova kerkesen per depozitimin ne Rregjistrin Tregtar te vendimit Nr.6 date 07.12.2006,te ortakut te vetem te shoqerise GIOAD sh.p.k.dhe dokumentacionin e paraqitur,

**K O N S T A T O V A**

Me vendimin Nr. 2198 date 01.03.1994;Nr.2198/1 date 24.02.2000;Nr.2198/2 date 17.10.2000;Nr.2198/3 date 02.04.2004;Nr.2198/4 date 15.06.2004 eshte regjistruar si person juridik shoqeria tregtare GIOAD sh.p.k.
Me vendimin Nr.2198/5 date 05.12.2006,eshte bere depozitimi I vendimit Nr.5 date 20.06.2006 te Ortakut te Vetem te Shoqerise Tregtare GIOAD sh.p.k. I cili ben fjale per rritjen e kapitalit te shoqerise dhe caktimin e ekspertes Nadire Hyseni.
Ne Vendimin Nr.6 date 07.12.2006 te Ortakut te vetem te Shoqerise Tregtare GIOAD sh.p.k eshte vendosur:

- Miratimi I raportit te paraqitur nga ekspertja kontabel e autorizuar znj. Nadire Hyseni,me Nr. License 43 date 10.02.2000, per zmadhimin e kapitali themeltar te shoqerise '' GIOAD'' sh.p.k. nepermjet rikapitalizimit te fitimeve te pashperndara nga ana e shoqerise si dhe te llogarise Ortake llogari likujduse,gjendje ne Bilanc te dates 31.12.2005.
- Zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ''GIOAD''sh.p.k sipas menyres se percaktuar ne raportin e Ekspertes kontabel te autorizuar.
- Zmadhimi I kapitalit themeltar te shoqerise ''GIOAD''sh.p.k. nga 100000 lek ne 20262316 lek.

Per sa me sipes kerkuesi kerkon depozitimin e Vendimit Nr.6 date 07.12.2006 te Ortakut te vetem te shoqerise ''GIOAD''.

**PER KETO ARESYE**

Ne baze te ligjit 7638 date 19.11.1992,per ''shoqerite tregtare'' dhe ligjit Nr. 7667 date 28.01.1993,per regjistrin tregtar

**V E N D O S A**

Pranimn e kerkeses.
Depozitimin ne regjistrin tregtar te Vendimit Nr.6 date 07.12.2006 te Ortakut te Vetem te Shoqerise Tregtare GIOAD sh.p.k.
Shenimin ne fleten perkatese ne kolonen________
Regjistrimi te behet me Nr.Rendor__________duke u ndare nga neri tjetri me vije te kuqe.

G J Y Q T A R E

# A K T   T H E M E L I M I

## (PER KRIJIMIN E SHOQERISE TE PERBASHKET ITALO SHQIPTARE)

## ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR " GIOAD " SHPK

Sot ne daten 19.Shkurt 1994 ne Durres hartohet ky akt themelimi me palet nenshkruese:

Giovanni Sacco i biri Nicola dhe Bughi Adele,lindur me 15.12.1945 ne Lecce dhe banues ne Lecce Via Cavallieri Ordine Vittorio Venetto 43,me kombesi Italiane.

Adil Beqiraj i biri i Vehbiut dhe Zyhras,lindur me 10.3.1958 ne Durres e banues ne Durres Lagj Nr.16 Rruga " Mujo Ulqinaku" Nr.140,me kombesi shqiptar

N E N I 1

Ne virtytet e presidentit ata themelojne ndermjet tyre nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar te quajtur "GIOAD ".SHPK .

N E N I 2

Shoqeria e perbashket italo_shqiptare"GIOAD"SHPKL" ka statusin juridik te saj dhe ka seline ne qytetin e Durresit Lagj Nr.16 Rruga"Mujo Ulqinaku" Nr.1- te Republikes Shqiperise

N E N I 3

Shoqeria private "GIOAD" SHPK do te zhvilloj aktivitetin e saj ne perputhje me dispozitat e ketij akt themelimi,statutit te saj dhe legjislacionit shqiptar ne pergjithesi si dhe ate tregtar nderkombetar.

N E N I 4

Shoqeria private "GIOAD" SHPK do te ushtroj veprimtarine e saj per nje he mbi 10 vjet.Ajo do te anullet vetem me pelqimin e ortakeve

N E N I 5

Shoqeria private "GIOAD" SHPK ka per objekt te veprimtarise se saj:

_ Tregtinin me pakice e me shumice i pjeseve te kembimit per te gjitha llojet e tipet e autoajeteve import_eksport

_ Tregtinin me shumice e pakice te paisjeve te ndryshme industriale, elektro shtepiake,konfeksione,prodhime kozmetike,ondulacioni,lende ndertimi, makineri e paisje,prodhime plastike e gome,lodra per femije import_eksport

_ Te kryeje te gjitha operacionet tregtare,ekonomike e financiare qe jane te lidhura me objektin e veprimtarise se saj dhe qe shihet e nevojshme ose e domosdoshme nga administratori i shoqerise

N E N I 6

Shoqeria private "GIOAD" SHPK ushtron veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj ne qytetin e Durresit si dhe ne qytete te tjera te Republi

se Shqiperise, duke u mbeshtetur ne parimin e likuiditetit, garancise ne vepri-
tarine e saj.

DURRES

NENI 7

Shoqeria private "GIOAD" SHPK mund ta marre pjese ne shoqeri te tjera qe kane objekt te njejte ose te ndryshem.

NENI 8

Shoqeria private e perbashket italo_shqiptare "GIOAD" SHPK ka nje kapita fillestar 100.000 Leke te holla te cilat jane te depozituara ne banke, eshte çelur dhe llogaria perkatese e kesaj shoqerie.

Ky kapital perbehet nga kontributet qe vijojne:

Zoti GIOVANI SACCO nenshkruan 50% te tere kapitalit social prej 50.000 leke .

Zoti ADIL BEQIRAJ nenshkruan 50% te tere kapitalit social prej 50.000 leke

[illegible]

Ne perputhje me nenshkrimet e mesiperme:

Zoti Giovani Sacco merr 100 kuota te kapitalit social

Zoti Adil Beqiraj merr 100 kuota te kapitalit social

NENI 9

Fitimi i shoqerise "GIOAD" SHPK do te ndahet si vijon:

Zoti Giovani Sacco merr 50%

Zoti Adil Beqiraj merr 50%

Fitimi do te realizohet pasi te behet likujdimi i detyrimeve te shoqeri pagimi i taksave dhe tatimeve te vendosura nga legjislacioni shqiptar.

Fitimi qe i perket ortakut italian mund ta transferohet sipas legjislac onit shqiptar.

NENI 10

Ortaket nuk mund ta perdorin pasurine e shoqerise per qellime te tjera perveç atyre te percaktuara ne kete kontrate dhe ne statut, pa marre pelqimin e njeri tjetrit.

Ortaket e shoqerise "GIOAD" SHPK pergjigjen vetem per detyrimet e saj.

Pjesmarrja ne shoqeri nuk i pengon ata qe te kene pavaresi ligjore dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e njeri tjetrit jashte kesaj shoqerie dhe nga veprimtari te tjera.

Pjesmarrja e ortakeve ne humbje nga veprimtaria e shoqerise "GIOAD

do te jete ne te njejten mase me fitimin nga veprimtaria e saj.

N E N I 11

Vlefshmeria e ketij akt themelimi eshte e pakufizuar ne kohe. Shoqeria"GIOAD
SHPK e fillon veprimtarine e saj me rregjistrimin e saj ne Gjykaten e Rreti
Tirane dhe ne organet financiare perkatese

N E N I 12

Per nevojat e ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te cele llogar
si ne Banken Kombetare te Shqiperise, ne cdo banke tjeter te njohur me ligj
private apo shteterore.

N E N I 13

Shoqeria vepron ne kushtet e prones private dhe merr persiper te drejta dhe
detyrime. Ajo pergjigjet per detyrimet e saja kontraktore dhe jashte kontrakt
re brenda kapitalit saj. Shoqeria ne nivelin e fitimit dhe te ardhurave te re
izuara duke perfshire dhe kapitalin fillestar, garanton rrezikun e veprimtari
se saj.

N E N I 14

Shoqeria private"GIOAD" SHPK do te mbaje lidhje me institucione, firma, sho
qeri, ndermarrje dhe individe private brenda dhe jashte vendit sipas dispozi
ve ligjore ne fuqi.

N E N I 15

Aktiviteti financiar i shoqerise do te kryhet nepermjet bankes se shtetit
Shqiptar.

N E N I 16

Vlersimi i artikujve, prodhimeve etj do te behet me ato cmime qe i cakto
vete shoqeria.

N E N I 17

Mbrojtja ligjore e shoqerise "GIOAD" SHPK do te behet sipas ketij akti,
statutit, rregullores e legjislacionit shqiptar.

N E N I 18

Asambleja e ortakeve eshte organi sovran i shoqerise. Vendimet qe merr a
mbleja ne perputhje me statutin dhe me legjislacionin ne fuqi te Republike
Shqiperise jane te detyrueshme per te dy ortaket.

Asambleja e ortakeve emeron presidentin dhe administratorin e shoqeris

N E N I 19

Ortaket kane te drejte te perfaqesojne shoqerine para organeve gjyqesore
administrative, institucione etj per te mbrojtur interesat e shoqerise.

N E N I 20

Secili ortak eshte i detyruar te paraqes dokumentat per blerje apo shitje s

dhe shpenzimet e tjera te kryera per shoqerine.

DURRES

N E N I 21

Secili ortak anetar i shoqerise ka te drejte te perfaqesohet ne asamble nga

nje person tjeter,por gjithmone duke i dhene perfaqsim ne shkrim.

N E N I 22

Shoqeria private "GIOAO" SHPK do te nxjerre bilancet mujore,tremujore,vj

jore per te kontrolluar ne çdo kohe efektivitetin e veprimtarise se saj.

Fitimi i shoqerise do te rezultoje pas zbritjes se volumit te pergjithshe

te detyrimeve qe lidhen me veprimtarine e saj.Keto detyrime perbehen nga sh

nzimet materiale e lende te pare,investime,amortizime,shpenzime transporti,

tatim takse,paga punonjesish etj ne baze te legjislacionit shqiptar.

N E N I 23

Krijuesit e shoqerise marrin persiper te perballojne rezultatet pozitive

dhe negative qe rrjedhin nga veprimtaria e shoqerise ne kufinjte e kapitali

te shoqerise"GIOAO " SHPK

N E N I 24

Problemet e punesimit n keto shoqeri trajtohen ne kontrata pune te veçan

ta per çdo punonjes qe do te merret ne pune konforme legjislacionit shqipt

te punes.

N E N I 25

Perfaqsimi i shoqerise do te behet nga ADIL BEQIRAJ , administratori i s

dhe ne raste te veçanta mund ta beje personat e autorizuar nga ata.

Administrator emerohet zoti Adil Beqiraj

N E N I 27

Kjo kontrate mund te ndryshoje me marrveshje te dy ortakeve,duke lidhur

per kete nje kontrate tjeter me shkrim.

N E N I 28

Ortaket kane te drejte te heqin dore nga kjo kontrate duke njoftuar per k

ortakun tjeter dy muaj me pare.Heqja dore behet me shkrim.

N E N I 29

Mosmarrveshjet ndermjet ortakeve zgjidhen si rregull me frymen e mirk

tizit.Ne rast se zgjidhja e tyre ne kete menyre eshte e pa mundur,secili

ortaket ka te drejte ti drejtohet gjykates se rrethit Durres.

Mosmarreveshjet e shoqerise " GIOAD "SHPK me te tretet do te shqyrtohen nga organet kopetente shqiptare, sipas legjislacionit shqiptar.

N E N I 30

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me pelqimin e ortakeve

N E N I 31

Te dy ortaket kane te gjitha kopetencat per te kryer praktikat e nevojshme per themelimin ligjor te shoqerise ne perputhje me ligjet ne fuqi.

N E N I 32

Te gjithashpenzimet per themelimin e shoqerise private "GIOAD S.r.l" jane ne ngarkim te shoqerise "GIOAD " SHPK

N E N I 33

Per nje administrim me te mire te shoqerise me qellim qe ajo te rritet ne kalimin e kohes te gjitho aktet e hartuara per permisimin e aktivitetit do te jene pjese perberese e ketij akti.

N E N I 34

Ky akt themelimi u perpilua ne tre kopje ne gjuhen shqipe qe ka te njejten vlere ligjore secila kopje.

N E N I 35

Kjo kontrate hyn ne fuqi pasi nenshkruhet nga Zoti Giovanni Sacco dhe Zoti Adil Beqiraj.

O R T A K E T

1_ Giovanni Sacco 2_ Adil Beqiraj

Sacco Gio [signature] [signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
NOTERIA DURRES.
Nr. Rep 605 Nr. Kol. 216

V E R T E T I M

Ne Durres, sot me date 17.2.1994, para meje Lejla Rifat Muzina notere ne gjykaten e rrethit Durres, u paraqiten personalisht Giovanni Sacco, i biri i Nicola, dtl. 1945, banues ne Lecce dhe Adil Beqiraj, i biri i Vebiut, dtl. 1958, banues ne Durres, te dy madhore dhe me zotesi proceduriale, te pa njohur prej meje personalisht per identitetin e te cileve u sigurova ne baze te leter njoftimeve personale qe mbanin me vehte, te cilet deklaruan se me Akt-Themelimin e me siperm eshte shprehur vullneti i tyre i lire, akt i cili nenshkruhet para meje noteres.

Une noterja vertetoj. - - - - - - - - - - - - - - - - - - -

N o t e r e [signature]

# S T A T U T

(I SHOQERISE PERBASHKET ITALO SHQIPTARE ME PERGJEGJESI)
(TE KUFIZUAR "GIOAD" SHPK )

Ne mbeshtetje te ligjit"Per sanksionimin dhe mbrotjen e prones privat
te nismes se lire,te veprimtarise private e te pavarur dhe te privatizimit
Nr.7512 date 10.8.1991 si dhe te dispozitave te tjera perkatese per krijimi
e shoqerise me baze pronen private,krijohet shoqeria me pergjegjesi te kuf
zuar"GIOAD SHPK ne baze te aktit themelues date 15.02.1994 me pale nenshk
ese:

Giovanni Sacco i biri Nicola dhe Bughi Adele,dtl 15.12.1945,lindur ne
Lecce dhe banues ne Lecce Via Cavallieri Ordine Vittorio Venetto 43,me komb
si italiane

Adil Beqiraj i biri i Vehbiut dhe Zyhras,dtl 18.8.1958,lindur ne Durre
dhe banues ne Durres Lagj Nr.16 Rruga" Mujo Ulqinaku" Nr.140,me kombesi shq
ptare.

Shoqeria private "GIOAD"SHPK ne kete statut ne perputhje me akt the
limin dhe legjislacionin shqiptar,rregullon poziten juridike te ortakeve d
te punonjesve te shoqerise,organizimin dhe objektin e veprimtarise se shoqe
se si dhe çeshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise

## K R E U I

### Dispozita te pergjithshme

N E N I 1

Personi qe do te firmosi aktin e themelimit,eshte themeluar nje shoqeri
me pergjegjesi te kufizuar ne konformitet me dispozitat ligjore ne fuqi ne
Republiken e Shqiperise dhe me nenet e percaktuara ne kete akt

N E N I 2

Shoqeria do te quhet "GIOAD" SHPK dhe ajo eshte person juridik privat

N E N I 3

Jetgjatesi e shoqerise"GIOAD" SHPK eshte percaktuar mbi 10 vjet duke f
lluar qe nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregtar.Jetgjatesia e saj
mund te zgjatet ose te shkurtohet sipas pelqimit te krijuesit.

N E N I 4

Shoqeria private "GIOAD " SHPK do te kete seline e saj ne qytetin e Du
rresit Rruga " Mujo Ulqinaku" Lagj Nr.16 Nr. 140.Transferimi i selise se sh
qerise ne adrese tjeter behet me pelqimin e ortakeve.

N E N I 5

Shoqeria private "GIOAD " SHPK do te kete seline e saj dhe vulen e cil

ka formen e drejtekombit ku shkruhet firma"GIOAO " SHPK Lagj nr.16 Rruga "
jo Ul... " Nr.140 Durres.

N E N I 6

Shoqeria private"GIOAO" SHPK ka per objekt te veprimtarise se saj:

_Tregtimin me pakice e me shumice te pjeseve te kembimit per te gji the llojet e tipet e autom jeteve import eksport

_Tregtimin me shumice e pakice te paisjeve te ndryshme industriale, elektro shtepiake, konfeksione, prodhime kosmetike, ondulacioni, lende ndertimi, makineri e paisje, prodhime plastike e gome, lodra per femije import eksport

_Te kryeje te gjitha operacionet tregtare, ekonomike e financiare qe jane te lidhura me objektin e veprimtarise se saj dhe qe shihet e nevojshme ose e domosdoshme nga ortaket.

K R E U II

N E N I 7

Ortaket gezojne keto te drejta kryesore:

_ Drejtimin e drejtperdrejti te shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin

_ Pjesemarrjen ne rezultatet e veprimtarise ekonomike te shoqerise, sipas kontrates dhe statutit

_ Pjesemarrjen vete ose me perfaqesuesit e tyre ne organet drejtuese te shoqerise qe mund te krijohen me marreveshje ndermjet paleve

_ Njohjen me te gjitha te dhenat qe kane te bejne me veprimtarine ekonomike e financiare te shoqerise dhe me te gjithe dokumentat e perpunuara pr saj

_ Heqjen dore nga shoqeria, mbasi ja afruar ne fillim interesat e vet ortakut tjeter.

N E N I 8

Ortaket kane keto detyrime kryesore:

_ Te depozitojne kuoten e tyre ose kuotat suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin

_ Te japin te dhenat e domosdoshme per realizimin e çdo objektivi te veçante qe lidhet me veprimtarine e shoqerise

_ Te kryejne detyrat e tyre te caktuara per realizimin e veprimtarise se shoqerise.

N E N I 9

Secili ortak ne qofte se heq dore nga shoqeria duhet te njoftoj vendimin e vet me shkrim dy muaj perpara.

Heqja dore nuk e çliron palen nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqeri se dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj pales qe heq dore.

Pala qe heq dore detyrohet tja afroj interesat e veta pales tjeter dhe kur ortaket nuk pranojne kete blerje mund tja shesin ato paleve te treta,po jo me çmim me te ulet nga ai i afruar ortakut te vet.

## K R E U III

### Kushtet Ekonomike te Shoqerise

### N E N I 10

Veprimtaria e shoqerise"GIOAD" SHPK realizohet ne baze te leverdise ek nomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

Shoqeria "GIOAD " SHPK mban kontabilitet te rregullt,sipas legjislacio shqiptar

### N E N I 11

Shoqeria private "GIOAD " SHPK ka nje kapital fillestar 100 000 leke re.Ky kapital perbehet nga kontributet qe vijojne

_Zoti Giovani Sacco i perkasin 50 000 leke ose 50%

_Zoti Adil Beqiraj i perkasin 50 000 leke ose 50%

Kapitali social eshte i ndare me 200 kuota me nga 5000 leke secila ne perputhje me nenshkrimet e mesiperme

_ Zoti Giovanni Sacco merr 100 kuota te kapitalit social

_ Zoti Adil Beqiraj merr 100 kuota te kapitalit social

Me marrveshje ndermjet tyre ata mund ta rrisin kapitalin baze me kuot suplementare te barabarta.

### N E N I 12

Kuotat e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te vendosura ne trashegimi,ne rast te prishjes se bashkesise sipas rradhes se trashegimise ligjore.Kuotat mund ti transferohen personave te trete vetem m pelqimin e ortakeve dhe per secilin ortak duhet ti afrohet ortakut tjeter e drejta parablerjes.Transferimi tek te tretet te kuotes sociale nuk mund te ndodhe ne kushte me te favorshme sesa ato te paraqitur ortakut.

### N E N I 13

Shoqeria "GIOAD" SHPK eshte pronare e pasurise se saj dhe ka te drejt e perdorimit dhe te disponimit te kesaj pasurie ne perputhje me qellimin e primtarise qe kryen.

### N E N I 14

Fitimi i shoqerise"GIOAD " SHPK ndahet si vijon:

50% ortaku Giovanni Sacco

50% ortaku Adil Beqiraj

N E N I 15

Rezultatet financiare te veprimtarise se shoqerise"GIOAD " SHPK cakto hen ne baze te bilanceve mujor, tremujor, vjetor

K R E U IV

Organet Drejtuese

N E N I 16

Organi vendimor i shoqerise "GIOAD" SHPK eshte asambleja e ortakeve. Asambleja perbehet nga te gjithe ortaket qe veprojne sipas dispozitave te k tij statuti. Vendimet e saja te marra ne pe puthje me ligjet dhe me statutin jane te detyrushme per te gjithe ortaket.

Asambleja e ortakeve vendos me unanimitet per ndryshimet e dispozitat e kontrates dhe te statu.it, per rritjen ose pakesimin e kapitalit, per mirat min e programit vjetor te veprimtarise se shoqerise, per pushimin e veprimta rise se saj dhe per çdo çeshtje qe e shoh te arsyshme. Asambleja zgjedh pres dentin dhe administratorin.

N E N I 17

Mbledhja e asamblese zhvillohet nje here ne tre muaj, por jo me pak se nj here ne vit, pas mbylljes se periudhes ushtrimore. Ne raste te veçanta mund thirren mbledhje te jashtezakonshme te asamblese.

N E N I 18

Thirrja e asamblese behet neperajet njoftimit me shkrim qe permban dite oren, vendin, rendin e dites se mbledhjes, te cilen e dergon jo me pak se 30 te nga data e caktuar per mbledhje. Ortaket mund te perfaqsohen nga nje per ne tjeter ne mbledhje i autorizuar nga ata.

N E N I 19

Asambleja ne mbledhjen e zakonshme dhe jashtezakonshme quhet e thirrur kur marrin pjese te dy ortaket. Asambleja merr vendime te vlefshme me unan mitet midis ortakeve

N E N I 20

asambleja perfaqson ate ne marrdhe nije me te tretet si dhe ka te drejten e firmes. Asambleja emeron nje sekre re qe mban proçes verbalet e mbledhjeve. Vendimet e asamblese vertetohen ng proçes verbali i firmosur nga Presidenti dhe sekretari

N E N I 21

Per drejtimin e veprimtarise se shoqerise "GIOAD" SHPK asambleja e or keve mund te emeroj nje keshill administrativ. Menyre e funksionimit dhe petencat e keshillit administrativ caktohen nga asambleja e ortakeve.

N E N I 22

Asambleja e ortakeve emeron komisjonin e kontrollit. Ne periudha kohe k
komisjon ben kontrollin e veprimtarise se shoqerise dhe informon asamblen
e ortakeve.

N E N I 23

Per zhvillimin e veprimtarise se saj shoqeria "GIOAD" SHPK mund te pu
soje persona te tjere. Marrdhenijet e punes me keta persona rregullohen ng
kontrata e punes. Per çeshtje qe nuk rregullohen nga kontrata e punes zbato
hen dispozitat e legjislacionit te punes.

N E N I 24

Administratori shoqerise drejton veprimtarine e shoqerise ne baze te vend
meve qe merr asambleja e ortakeve. Ai organizon punen ne te gjitha drejtime
dhe ka te drejte te veproje ne emer dhe per llogari te shoqerise. Presiden
i shoqerise ka te drejte te lidhe marrdhenije kontraktore me firma e shoq
ri te tjera private dhe shtetrore brenda dhe jashte vendit. Perfaqson shoq
rine dhe ne raste te veçanta mund ta perfaqsoje ate nje person i autorizu
dhe caktuar prej tij.

N E N I 25

Administratori kryen keto funksione:

_Organizon dhe drejton punen per mbarvajtjen e veprimtarise se shoq
rise

_ Ne mungese te presidentit te shoqerise perfaqson shoqerine

_ Propozon organizimin e shoqerise dhe cakton numrin dhe strukturen e
kualifikimit te punonjesve

_Lidhe kontrata dhe kryen veprime te tjera juridike brenda kufinjve t
vendimeve te asamblese

_Kryen te gjithe punet e shoqerise, te cilat sipas ketij statuti nuk j
ne ne kopetence te presidentit.

<u>K R E U  V</u>

N E N I 26

Viti financiar_ bilanci i shoqerise fillon me 1.Janar 1994
e mbydhet me 31.Dhjetor 1994. Brenda tre muajve te fundit te vitit financia
asambleja duhet te aprovoje bilancet vjetore te specifikuara, relacionin e
administratorit, inventarin, kontabilitetin vjetor

<u>K R E U  VI</u>

Marrdhenijet e punes

N E N I 27

Marrdheniet e punes ne shoqeri rregullohen ne perputhje me kontraten e krijimit te shoqerise,legjislacionin shqiptar te punes dhe me kete statut.

Ne kontraten e punes rregullohen keto qeshtje:

_ Kushtet dhe menyra e marrdhenies se punes

_Fillimi dhe vendi i punes

_ Caktimi i kohes punes,puna jashte kohes normale,festat dhe ditet e pushimit

_Pushimet dhe mungesat,te drejtat dhe detyrimet dhe pergjegjesia e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes

_ Nderprerja e marrdhenies se punes

N E N I 28

Punonjesi per punen e tyre do te marrin pagen ne vertesi me rezultatet e arritura ne pune,ne perputhje me kontraten e punes.Ne kontraten e punes percaktohet paga e punes se punonjesit,shperblimi mbi pagen dhe shperblimet te tjera.

N E N I 30

Punonjesi eshte personalisht pergjegjes per kryerjen e puneve ta caktuara.Po keshtu punonjesi pergjigjet materialisht per demet qe mund ti shkakatoje shoqerise gjate punes.Ai ruan sekretin e punes si dhe dokumentat dhe vendimet qe jane shpallur se sekrete nga asambleja e ortakeve.Punonjesi duhet ti kryeje detyrat me ndergjegje,cilesi,ne menyre te ligjshme dhe profesionale

## K R E U VII

Fitimi i shoqerise

N E N I 31

Pas perballimit te detyrimeve,taksave,tatimeve dhe shpenzime te tjera fitimi i shoqerise perdoret per vete dhe per investime.

N E N I 32

Krijuesit e shoqerise mbartin ne vehte rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara me rastin e krijimit te shoqerise.Ne qofte se humbjet e shoqerise nuk mund te mbulohen me mjetet e krijimit te shoqerise,shoqerise i hapet procedura e likujdimit,perkatesisht falimentimit.

## K R E U VIII

Shtyrja e afatit,zgjidhja,likujdimi

N E N I 33

Ne fund te jetgjatesise te percaktuar ne nenin 3 te ketij statuti sh

rja e afatit te jetgjatesise mund te vendoset nga asambleja me aprovimin una nim te ortakeve.

N E N I 34

Aktiviteti i shoqerise nderpretet :

_Me mbarimin e jetgjatesise te percaktuar ne nenin 3 te ketij statut

_Ne raste e percaktuara ne legjislacionin shqiptar

_Me pelqimin e njerit prej ortakeve per shkaqe te perligjura

_ Kur hapet proçedura e likujdimit,perkatesisht e falimentimit

N E N I 35

Shoqeria hyn ne proçesin e likujdimit ne momentin e anullimit te saj.Per likujdimin asambleja emeron nje ose shume likujdues te cilet paraqesin rapor tin mbi situaten e aktivit e pasivit te shoqerise,mbi operacionet,likujdimin dhe jetgjatesine e domosdoshme.Ne fund te proçesit asambleja vendos mbi bila ncin financiar final mbi rregullimin e aktit te likujdimit dhe mbylljen e proçesit te likujdimit.Pasi te kete paguar te gjithe kreditoret dhe pasi te kete marre te gjithe kreditet,likujduesi ndan kapitalin ndermjet ortakeve p pocionalisht sipas kuotes qe ata zoterojne.

N E N I 36

Transferimi i kesaj shoqerie ne nje shoqeri,ne emr kolektiv ose ne nje sho ri te thjeshte ne ortakeri me pergjegjesi te ndryshme mund te behet vetem m aprovimin unanim te ortakeve.

N E N I 37

Te gjithe mosmarrveshjet qe mund te lindin ndermjet ortakeve,ndermjet sho rise se ortakeve,gjate egzistences se shoqerise,gjate likujdimit te saj,do percillen nje gjyqi kopetent shqiptar ose nje kolegji arbitrash.Ne rastin e kolegjit arbitrar secila nga palet do te meroje nje perfaqsues dhe keta do emerojne nje te trete.Ne rast mosmarrveshjesh te pjestarit te trete do te rohet nga kolegji avokateve.

K R E U VIIII

Dispozita e fundit

N E N I 38

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyr é proçedure me te cilen eshte nxjere ky statut.Ky statut hun ne fuqi diten qe nenshkruhet nga ortaket.Ky statut u radaktua ne tre kopje ne gjuhen shq dhe secila kopje ka te njejten vlere ligjore.

Sacco

O R T A K E T

1_ Giovanni Sacco

2_ Adil Beqiraj

**Nadire HYSENI**
Eksperte Kontabel e Autorizuar
Rruga "*Skenderbeg*", L.nr. 3, Durres
*Tel.* 052.212.74; *Mob.* 069.23.97381
*Liç. Prof.* Nr.43; *kod fiskal*: 540855

## AKT – EKSPERTIZE

**Per vleresim shtese kapitali te shoqerise "GIOAD" sh.p.k.**
**DURRES**

Une, Nadire HYSENI, Eksperte Kontabel e Autorizuar, me liçence nr. 043, leshuar me 10.02.2000, me cilesine e Ekspertes per vleresimin e kapitalit te shoqerise "GIOAD" sh.p.k. – emeruar me vendim te Gjykates Rrethit Gjyqesor Tirane, Nr. 2198/5 dt. 05.12.2006 dhe ne baze te Vendimit nr. 5 dt. 20.06.2006 te Ortakut te Vetem, pasi ekspertova te gjithe dokumentacionin qe lidhet me zmadhimin e kapitalit te Shoqerise, konstatova se treguesit financiar te kesaj Shoqerie kane nje ecuri te mire; Shoqeria ka vazhdimesi te qendrushme dhe siguri te veprimtarise te saj.
Per te rritur me tej treguesit financiar dhe kredibilitetin ndaj te treteve, Shoqeria duhet te beje zmadhimin e Kapitalit Themeltar. Ky veprim mbeshtetet ligjerisht ne statutin dhe akt-themelimin, si dhe nenin 62 te ligjit nr. 7638 dt. 19.01.1992 *"Per shoqerite tregetare"* nepermjet kalimit ne te, te fitimeve te pashperndara dhe llogarise "Ortak - Llogarise likujduese", sipas gjendjes te bilançit date 31.12.2005.
Treguesit financiar te paraqitura ne kete bilanç, jane:

### A – NE PASIV

| | |
|---|---|
| 1. Kapitali Themeltar (nenshkruar) | 100.000 leke |
| 2. Ne zerin *"Fitime"* (rrjeshti 60.61), paraqitet gjendja e fitimeve te realizuara gjat viteve te mepareshme dhe vitit 2005, pasi jane zbritur te gjitha tatim-fitimet e paguara ne buxhet per shumen | 5.149.488 leke |
| 3. Ne zerin *"Rezerva Ligjore"*, (rrjeshti 57) | 10.000 leke |
| 4. Provizione per rreziqe | 1.403.531 leke |
| 5. Ortak-Llogari Likujduese | 15.112.828 leke |
| 6. Kredi Bankare | 17.593.842 leke |
| 7. Detyrime Tjera | 57.147 leke |
| **T o t a l i** (1+2+3+4+5+6+7) : | **39.426.836 leke** |

### B – NE AKTIV TE BILANÇIT

Keto burime financiare (fitimet neto te realizuara e te perdorura) te cilat jane materializuar ne Shoqeri ne formen e aseteve te qendrueshme, si: makineri e paisje dhe te tjera ne shfrytezim, gjendje mallerash ne magazine per shitje, si dhe gjendje CASH-it ne banke e arke, jane si me posht:

EKSPERTE KONTABEL E AUTORIZUAR
NADIRE HYSENI
Liç. Nr 113 D. 10.2.2000
DURRES ALBANIA

1 Makineri e Paisje pune — 597.973 leke
2. Te tjera ne shfrytezim — 251.932 leke
3. Amortizimi — - 354.000 leke
4. Produkte dhe malleva — 33.992.404 leke
5. Inventar ne perdorim — 315.112 leke
6. Kerkesa per arketim — 4.320.431 leke
7. Likujditete (Cash banka+arka) — 302.984 leke
(nxjerre nga llogaria e bankes dt.31.12.2005)

**T o t a l i** (1+2+3+4+5+6+7) : **39.426.836 leke**

